



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori I 2021

Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	4
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare	4
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	6
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	7
4. Treguesit e shërbimit ekspres.....	8

I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e parë të vitit 2021 dhe krahasimet me tremujorin e katërt të vitit 2020 dhe me tremujorin e parë të vitit 2020, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP”-“Shërbimet Postare”

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e parë të vitit 2021 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (28 subjekte):**

1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S);
2. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx);
3. DHL International (Albania) sh.p.k;
4. TNT Express Albania sh.p.k;
5. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex);
6. United Transport sh.p.k (Uni Trans);
7. Youth Albania Professional Services (YAPS);
8. E-KOMPLET sh.p.k;
9. COEX shpk;
10. Albanian Parcel Distribution shpk;
11. Speed Couriers Albania (Albi Shkurta – person fizik);
12. Intex Courier sh.p.k;
13. Turboo Albania sh.p.k;
14. Panorama Group sh.a;
15. Flash Delivery Albania;
16. Balkan Courier & Logistics sh.p.k;
17. IVY sh.p.k;
18. Alopost sh.p.k.
19. Prime Express sh.p.k;
20. All In One Cool sh.p.k;
21. Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k;
22. Fast Delivery sh.p.k;
23. Mr. Courier sh.p.k;

- 24. Top Post sh.p.k;
- 25. HDC Express
- 26. Fenix Post & Delivery Albania sh.p.k;
- 27. Greenposta sh.p.k;
- 28. Click and Buy sh.p.k.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

- 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
- 2. Treguesit e shërbimit universal postar;
- 3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
- 4. Treguesit e shërbimit ekspres

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 rezultojnë 6,940,395 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

Tabela 1.1- Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara në tremujorin e parë 2021 dhe krahasimi me tremujorin e katërt 2020 dhe me tremujorin e parë 2020.


Shërbime postare të ofruara	T1_2020	T2_2020	T3_2020	T4_2020	T1_2021	Ndryshim T1_2021/ T4_2020	Ndryshim T1_2021/ T1_2020
Posta Shqiptare sh.a							
1 Shërbim Universal Postar							
1.1 Postë brenda vendit	5,306,046	2,905,495	4,515,612	4,760,385	4,989,939	4.8%	-6%
1.2 Postë ndërkombëtare	162,172	73,152	449,011	219,001	175,779	-19.7%	8%
1.3 Totali 1.1+1.2	5,468,218	2,978,647	4,964,623	4,979,386	5,165,718	3.7%	-6%
2 Shërbim joniversal postar							
2.1 Postë brenda vendit	330,349	165,027	188,496	189,640	136,189	-28.2%	-59%
2.2 Postë ndërkombëtare	620	290	159	198	388	96.0%	-37%
2.3 Totali 2.1+2.2	330,969	165,317	188,655	189,838	136,577	-28.1%	-59%
3 Shërbim ekspres							
3.1 Ekspres brenda vendit	138,772	126,563	120,632	100,564	144,200	43.4%	4%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	3,465	1,988	3,986	3,435	4,779	39.1%	38%
3.3 Totali 3.1+3.2	142,237	128,551	124,618	103,999	148,979	43.3%	5%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare							
4 Shërbim JoUniversal Postar							
4.1 Postë brenda vendit	221,482	484,711	701,719	677,751	720,541	6.3%	225.3%
4.2 Postë ndërkombëtare	9,650	10,609	13,202	25,668	16,830	-34.4%	74.4%
4.3 Totali 4.1+4.2	231,132	495,320	714,921	703,419	737,371	4.8%	219.0%
5 Shërbim ekspres							
5.1 Ekspres brenda vendit	588,199	630,510	769,419	788,390	683,062	-13.4%	16.1%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	52,892	56,336	77,529	83,771	68,688	-18.0%	29.9%
5.3 Totali 5.1+5.2	641,091	686,846	846,948	872,161	751,750	-13.8%	17.3%
6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	6,813,647	4,454,681	6,839,765	6,848,803	6,940,395	1.3%	1.9%

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T1 2021

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,451,274	79%
<i>Of. e tjerë</i>	1,489,121	21%
<i>Totali</i>	6,940,395	100%

Për sa rezulton nga të dhënat e reflektuara në tabelën 1.2 sa më sipër, për tremujorin e parë të vitit 2021 Posta Shqiptare zë rreth **79%** të tregut postar përkundrejt Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të cilët së bashku zënë **21%**.

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor




Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, Posta Shqiptare në tremujorin e parë 2021 ka realizuar 5,451,274 shërbime postare, shifër e cila përkthehet në 178,051 objekte postare më shumë se tremujori i katërt 2020, sikundër ofruesit e shërbimeve postare në tremujorin e parë 2021 kanë realizuar 86,459 objekte postare më pak se në tremujorin e katërt të vitit 2020.

Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1-2021

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
5,165,718	873,948	900,729	6,940,395
74.4%	12.6%	13%	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 74.4% ose 5,165,718 objekte postare, ndjekur nga shërbimi ekspres me 13% ose 900,729 objekte postare. Shërbimi jo universal zë 12.6% ose 873,948 objekte postare.

Grafiku 1.2 Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet qartë që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar, i cili luhetet në nivelet rreth 74% për tremujorin e parë të vitit 2021. Nga krahasimi i periudhës T1-2021 me periudhën T4-2020, vërehet një rritje e numrit të shërbimeve postare në masën 91,592 shërbime, sikundër nga krahasimi i tremujorit të parë të vitit 2021 me tremujorin e parë të vitit 2020 vërehet një rritje e shërbimeve postare në masën rreth 126,748 shërbime.


2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T1-2021

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,989,939
Postë ndërkombëtare	175,779
Totali	5,165,718

Nga të dhënat e tabelës 1.4 vihet re se gjatë tremujorit të parë 2021, për sa i përket shërbimit Universal Postar, Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,165,718 objekte, nga të cilat Postë brenda vendit 4,989,939 ose 97%, dhe Postë ndërkombëtare 175,779 objekte, ose 3%. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 4,271,073 shërbime për objekte të thjeshta dhe 718,866 shërbime për Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 30,260 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 145,519 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujor



3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare


Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T1 2021	Pjesë tregu T1 2020
Shërbim universal postar	5,165,718	95%	92%
Shërbim jo universal postar	136,577	3%	6%
Shërbim ekspres	148,979	3%	2%

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 5,165,718 objekte postare ose 95%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 148,979 objekte postare ose 3% dhe shërbimi jo universal me 136,577 objekte postare ose 3%.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare gjatë 3-mujorëve të vitit 2020 dhe 3-mujorit të parë të vitit 2021, nga ku vihet re një rritje për shërbimin universal dhe për shërbimin ekspres, si dhe një rënie për shërbimin jo universal postar krahasuar kjo me tremujorin e mëparshëm.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T1 2021	Pjesë tregu T1 2020
P.Sh	136,577	16%	59%
Of. e tjerë	737,371	84%	41%
Totali	873,948	100%	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se për sa i përket shërbimit jo universal postar, treguesit më të mirë i kanë Ofruesit e tjerë me 737,371 objekte postare ose 84% të tregut, kundrejt Postës Shqiptare me 136,577 objekte postare ose 16%.

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në tremujorin e parë 2021 krahasuar me tremujorin e katërt 2020 kanë pësuar rënie për Postën Shqiptare me 53,261 objekte, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë rritur me 33,952 objekte. Nga krahasimi mbi bazën e periudhave tremujore, konstatohet rënie e pjesëve të tregut të Postës Shqiptare për këtë shërbim duke arritur në 16% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020, ku pjesa e tregut të Postës Shqiptare për këtë tregues ishte rreth 59%.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 përbëhej nga 856,730 objekte brenda vendit dhe 17,218 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.


5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2021, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2020, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për tremujorin e parë 2021.

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T1 2021	Pjesë tregu T1 2020
P.Shqiptare	148,979	17%	18%
Of. e tjerë	751,750	83%	82%
Totali T1-2021	900,729	100%	100%

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Siç vihet re, për sa i përket shërbimit ekspres, gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2020, sikundër vërehet rënie në shërbimet postare ekspres për tremujorin e parë të vitit 2021 e krahasuar kjo me tremujorin paraardhës (T4–2020). Gjithashtu, për shërbimin ekspres vërehet një rënie e pjesëve të tregut për Postën Shqiptare, ku nga rreth 18% të tregut për këtë tregues në tremujorin e parë të vitit 2020, pjesa e tregut të Postës Shqiptare në tremujorin e parë të vitit 2021 ka arritur në rreth 17%, përkundrajt rreth 83% të ofruesve të tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 827,262 objekte postare ose 92%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 73,467 objekte postare ose 8%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri paraqitet në vlerën 45,801 objekte postare, shifër kjo dukshëm më e madhe se sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit në vlerë 27,666 objekte.